



# Buletini

- \* Aktivitetet e përgjithshme
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)

\*

Prill 2020

## Aktivitetet e përgjithshme

Gjatë muajit prill, si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 the masave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, AD ne koordinim me Këshillin Drejtues, dhe në bashkëpunim me KGJK, KPK , donatorët si dhe projektet e ndryshme që e asistojnë AD, ka ndërmarr dhe zhvilluar një mori aktivitete, si trajnuese ashtu edhe koordinuese me qëllim të vazhimit të aktiviteteve të planifikuara nëpërmes mjeteve dhe komunikime elektronike.

Në funksion të zhvillimit të veprimtarisë, menaxhmenti dhe stafi i AD-së , në koordinim me trajnuesit, gjyqtarët, prokurorët si dhe stafin e bashkëpunëtorëve të gjykatave dhe prokurorive, kane zhvilluar planet dinamike ku aktivitet trajnuese të zhvillohen dhe realizohen nga shtëpitë.

Fillimisht AD, ka abonuar dy platforma ZOOM Pro, për zhvillim të trajnimit në mënyrë virtuale, si dhe është mundësuar qasja për të gjithë të interesuarit në platformën e mësimi në distance E learning. Përkundër vështirësive dhe hezitimit të përfituesve, kjo mënyrë e të mësuarit ka rezultuar të jetë shume efektive dhe produktive dhe pjesëmarrja ka qenë jashtëzakonisht e madhe, gjë që ka mundësuar që Akademia të vazhdoje pa ndërprerje në zbatimin dhe realizimin e programit trajnues për vitin 2020.

Pra , ne koordinim me KGJK dhe KPK , respektivisht pas vendimeve të nxjerra për vazhdimin e Programit të Trajnimeve Fillestare, Akademia e Drejtësisë është angazhuar dhe me sukses ka realizuar programin për trajnimin fillestar si për gjyqtarët e sapoemëruar ashtu

edhe për prokurorët e sapoemëruar. Të gjitha trajnimet janë realizuar nëpërmes platformës ZOOM Pro ku është mundësuar edhe përkthimi i nevojshëm në gjuhët zyrtare për pjesëmarrësit. Gjithashtu e njëjta praktike është realizuar edhe në Programin për Trajnimet e vazhdueshme, ku pjesëmarrja ka qenë jashtëzakonisht e madhe dhe trajnimet janë zhvilluar sipas planifikimit në programin e trajnimit.

Bashkëpunimi me donatorë dhe projekte ka qenë evidentë edhe gjatë kësaj periudhe. Me përfaqësuesit e zyrës së OPDAT-it të Ambasadës Amerikane, Drejtori Ekzekutiv i AD-së ka realizuar takime të cilat kishin për fokus zhvillimin dhe avancimin e moduleve të trajnimit me theks të veçantë për Konfiskimin e pasurisë nga vepra penale, Mashtrimin në prokurimin publik si dhe Dhunën në familje si dhe zhvillimin e kurikules së trajnimit për trajner TIT.

Përgjatë muajit prill, AD ka zhvilluar takime virtuale edhe me përfaqësuesit e projektit të GIZ/LARP, me ç ‘rast është diskutuar ndihma dhe asistencë e këtij projekti, si dhe mundësia e zhvillimit të modulit të trajnimit “Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative-Udhëzuesi praktik” sipas specifikave të platformës E learning të AD -së.

Takime virtuale janë zhvilluar edhe me përfaqësues të Projektit të BE-së “Mbështetje Kodit Civil Faza 2” në kuadër të cilave është arritur pajtimi për vazhdimin e bashkëpunimit me ç ‘rast janë ri caktuar datat e trajnimeve që kanë qenë të planifikuara të zhvillohen në bashkëpunim me këtë projekt.

Ne vazhdën e bashkëpunimit me projektet e Këshillit e Evropës, gjegjësisht iniciativës HELP është zhvilluar një takim virtual me pjesëmarrësit që janë duke e ndjekur trajnimin “Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje”, e që pjesëmarrës ishin edhe përfaqësuesit e zyrës qendrore të KE në Strasburg.

Ndërsa, takime virtuale koordinuese janë zhvilluar edhe me projektet e USAID -it JSSP

dhe CJA , në lidhje me modulet e trajnimit për Menaxhimin e Gjykatave, si dhe vlerësimi i nevojave për trajnime në fushën komerciale . Gjithashtu takime janë zhvilluar edhe me projektin KOSEJ në lidhje me modulet trajnuese në lidhje me indikatorët dhe metodologjinë e CEPEJ-it për matjen e efikasitetit të drejtësisë në Kosovë.

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar-në lëmin civile


Më 15-16 prill 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin me temë: “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëmin civile” në kuadër të PTV-së. Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom Pro. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 15.04.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 16.04.2020 nga ora 13:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në lëmin civile.

Në dy ditët trajnimit u trajtuan temat në vijim: Korniza ligjore vendore për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile, Rregulloret e BE-së për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile, Rregulloret Bruksel I, Bruksel II, Rome I. dhe Rregulloret Nr. 805/2004, 1393/2007, 650/2012, 4/2009 si dhe Konventat e Hagës për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në çështjet civile.

Në trajnim u potencua se kur flitet për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar në lëmin civile, kryesisht mendohet për çështjet që kanë të bëjnë me njohjen dhe përmbarimin e vendimeve të huaja gjyqësore apo vendimeve ekuivalente me këto. Kjo tematik ndër të tjera ngërthen procedurën për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në lëmin civile për kërkesat që burojnë nga Republika e Kosovës, apo nga shtetet e huaja për Kosovën, rolin e gjykatës dhe Departamentit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (DBNJ) në këtë procedurë, juridiksioni në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe kompetencën sipas ligjit mbi arbitrazhin, konventat ndërkombëtare që rregullojnë çështjen e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet civile, siç janë:

Konventa e Luganos, Konventa e Hagës, si dhe



disa prej konventave më të rëndësishme që rregullojnë çështjen e cekur më lartë.

Gjithashtu në trajnim u shtjelluan edhe aktet më të rëndësishme të miratuara nga Bashkimi Evropian, siç janë Traktati i Amsterdimit, Rregullorja Brukseli I, Urdhëresa Evropiane për Pagesë, Rregullorja mbi dorëzimin e dokumenteve nr.1393/2007, Rregullorja për bashkëpunimin ndërmjet gjykatave të shteteve anëtare për marrjen e provave në çështje civile dhe tregtare etj. Në fund u diskutua edhe rreth njohjes dhe përmbarimit të dokumenteve të huaja përmbarimore, si dhe procedurën e njohjes së vendimit të huaj sipas Ligjit për Zgjidhjen e Konfliktëve të Ligjeve.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj praktik, ku secili nga pjesëmarrësit pati mundësin të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit. Gjithashtu u përdorën dhe u shtruan skenarë të rasteve që përfshinë disa çështje praktike të bashkëpunimit ndërkombëtar që gjyqtarët po i hasin në punën e tyre të përditshme.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar.

## Sekuestrimi dhe konfiskimi

Më 22-23 prill 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, në bashkëpunim me Departamentin Ligjor të SHBA-së/OPDAT, realizuan trajnimin, me temë “Sekuestrimi dhe konfiskimi”.

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19 në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom Pro. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 22.04.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 23.04.2020 nga ora 13:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve me dispozitat Ligjore lidhur me Ligjin për Kompetencat e zgjeruara të Ligjit për Konfiskim dhe Sekuestrim (LKZK).


Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtar u trajtuan institutet e reja të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskim, përputhshmëria dhe kontinuiteti i dispozitave të

sekuestrimit dhe konfiskimit në ligjet bazike si KPRK dhe KPPK me LKZK-në, dallimet mes KLZK-së vjetër dhe LKZK-së së re, përputhshmëria e instituteve të reja të LKZK-së me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe KEDNJ-së.

Vëmendje iu kushtua masave që mund të propozohen për sigurimin e pasurisë dhe cilat janë masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë, për të cilin prokurori i shtetit ka prova të artikulueshme që tregojnë dyshim të bazuar se është përdorur në veprën penale nën hetim, është provë e veprës penale nën hetim, ose është fituar nga vepra penale nën hetim.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive në mes të pjesëmarrësve në trajnim dhe të trajnuesve të angazhuar vendor dhe ndërkombëtar.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës si dhe bashkëpunëtorë profesional.



## Roli dhe rëndësia e LPPA-së në organet administrative – Akti administrativ

Më 29-30 prill 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme organizoj trajnimin me temë: “Roli dhe rëndësia e LPPA-së në organet Administrative -Akti Administrativ”. Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom Pro. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 29.04.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 30.04.2020 nga ora 13:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e rolit dhe rëndësisë së LPPA-së në organet administrative konkretisht - aktit administrativ. Në dy ditët trajnimit u trajtuan temat në vijim: Roli dhe rëndësia e LPPA-së në organet administrative, Kuptimi dhe rëndësia e aktit administrativ si dhe koha e hyrjes në fuqi të tij, Zbatimi i drejtë i dispozitave të LPPA-së dhe Interpretimi i Udhëzuesit për procedurën administrative. Me fokus të veçantë u shtjellua akti administrativ, forma, përmbajtja, hyrja në fuqi, zbatimi si dhe shfuqizimi i tij. Në trajnim vëmendja u fokusua në procedurën administrative konkretisht në temat që lidhen me kohën e hyrjes në fuqi të aktit administrativ, zbatimin e aktit administrativ individual dhe kolektiv, si dhe revokimin dhe shfuqizimin e aktit administrativ. Ndërsa lidhur me Udhëzuesin për procedurën administrative u potencua se ka për qëllim që të lehtësoj zbatimin e LPPA-së nga ana e organeve të administratës publike, gjyqtarëve, personave fizik dhe juridik.

Gjithashtu në trajnim u shtjelluan edhe u ofruan zgjidhje praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësojnë punën e gjykatës dhe organeve administrative dhe në instancë të fundit do të ndikojnë në reduktimin e përgjithshëm të numrit të lëndëve në këtë lëmi.



Në trajnim u veçua konstatimi se Vendimi paraqet aktin administrativ me të cilin vendoset çështja administrative dhe me të cilin krijohen pasoja juridike. Vendimi përkufizohet si akt administrativ me të cilin organi kompetent vendos mbi objektin, çështjen konkrete administrative, mbi ndonjë të drejtë, detyrim ose interes juridik, duke aplikuar drejtpërdrejt dispozitat juridike materiale. Akti administrativ paraqet akt formal i përcaktuar me ligj, që do të thotë se akti administrativ ka formën e shkruar, përjashtimisht të rasteve kur me ligj kërkohet një formë tjetër apo kur një gjë të tillë e imponojnë rrethanat tjera.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste, dhe shembuj konkret. Kjo metodologji ngërtheu diskutime interaktive. Materiali i këtij trajnimi përmban komente, shënime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat e procedurës së përgjithshme administrative me fokus të veçantë aktin administrativ dhe elementet e tij. Gjithashtu u përdorën dhe u trajtuan në hollësi shembuj të zgjedhur nga Udhëzuesi për procedurën administrative.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e nivelit të Apelit dhe nivelit themelor (Departamentit për Çështje Administrative), si dhe zyrtarët e administratës publike të nivelit komunal dhe qendrorë.

## Punëtori

### Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje


Më 29 prill 2020, në kuadër të kursit të vazhdueshëm HELP, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, realizuan punëtorinë në platformën Zoom me temë "Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje"

Qëllimi i punëtorisë ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve me çështjet që kanë të bëjnë me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave me qëllim të zbatimit konsekuentë të të gjitha akteve juridike të brendshme me theks të veçantë Konventës së Stambollit.

Gjatë kësaj punëtori On-line në platformën Zoom u diskutua realizimi i Kursit on-line i cili është ndjekur nga gjyqtarë, prokurorë, mbrojtës të viktimave, zyrtar policor si dhe pjesëmarrës tjerë nga të gjitha regjionet e Kosovës, i cili Kurës ka përfshinte 7 module të cilat në përmbajtje kanë trajtuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.

Këto module kanë qenë të shoqëruara me akte të brendshme juridike si Kushtetuta, Kodin Penal, ligjin për mbrojtjen nga dhuna në familje, po ashtu edhe Konventën e Stambollit, duke përfshirë strategji dhe broshura të ndryshme të cilat kanë trajtuar dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave. Vëmendje gjatë këtij sesioni iu kushtua trajtimit të dhunës në familje dhe implikimet e saj në të drejtat e njeriut duke bërë vështrime krahasimore edhe me aktgjykimet e Gjykatës Evropiane të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut, të cilat kanë vënë bazat se si ndëshkohet një shtet nëse nuk ndërmerr masat e nevojshme për mbrojtjen e viktimës së dhunës në familje.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë, mbrojtës të viktimave, avokat dhe zyrtar tjerë.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit prill është vazhduar me realizimin e trajnimit teorik në formë virtuale përmes platformës online. Në kuadër të trajnimit teorik për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar (8) sesione trajnuese nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare dhe Legjislacioni dhe shkathtësitë plotësuese.

Nga nën moduli: “Ngritja e shkathtësive sociale për prokurorë janë realizuar tre (3) sesione trajnuese ku prokurorët e sapo emëruar patën rastin të përfitojnë njohuri të reja për çështjet si: individin dhe mjedisin social, motivacionet dhe emocionet profesionale dhe individuale, ndikimin e emocioneve në punë dhe kuptimi i çrregullimit psikik, emocional dhe fizik, konfliktet e brendshme dhe të jashtme.

Në kuadër të nën modulit: “Menaxhimi i stresit” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë shtjelluar: menaxhimi i kohës si predispozit e menaxhimit të stresit, stresi i pashmangshëm dhe atakimi i personalitetit në punë si dhe arsyeshmëria dhe relevanca me teknikat e ndryshme për menaxhimin e stresit dhe ndikimi i stresit.

Nga nën modulit: “Kodi i drejtësisë për të mitur”

është realizuar një (1) sesion trajnues me ç’ rast pjesëmarrësit avancuan njohuri lidhur me dispozitat e përgjithshme që e karakterizojnë procedurën penale ndaj të miturve, urgjencën e procedurës dhe afatet e shkurtra, mos gjykimi i të miturve në mungesë dhe parimi i konfidencialitetit dhe oportunitetit.

Në kuadër të nën modulit: “Ndërmjetësimi” janë realizuar dy (2) sesione me ç’ raste janë trajtuar: ndërmjetësimi në çështjet penale dhe rëndësia e tij, parimet e drejtësisë restauruese dhe efektet pozitive të ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës.

Gjatë realizimit të trajnimit teorik, prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar edhe formën e bashkëbisedimit me trajnuesit duke parashtruar kështu edhe pyetje rreth rasteve të ndryshme me të cilat ballafaqohen në punën e tyre në prokurori.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar nuk kanë realizuar trajnim praktik në prokurori.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar gjenerata e (VIII).






## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar


Gjatë muajit prill është vazhduar me realizimin e trajnimit teorik përmes platformës online “Zoom” sipas kalendarit trajnues. Në kuadër të trajnimit teorik për gjyqtarët e sapoemëruar janë realizuar (5) sesione trajnuese nga moduli: Kodi i Procedurës Penale.

Nga nën moduli “Provat në procedurën penale” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku gjyqtarët kanë pasur mundësi të thellojnë njohuritë e tyre në: Provat e nevojshme për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, rregullat e përgjithshme për provat në procedurën penale, provat dhe rendin në gjykatë, përdorimin e deklaratave të mëparshme gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe provat për përcaktimin e fajësisë.

Në kuadër të nën modulit “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale” kanë realizuar dy (2) sesione trajnuese, ku gjyqtarët u informuan lidhur me: Marrjen në pyetje dhe deklaratat e dëshmitarëve para ngritjes së aktakuzës, mos paraqitjen e dëshmitarit, marrja në pyetje dhe e deklaratës në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë, procesverbali i veprimeve në procedurë dhe regjistrimi i seancave me incizim audio dhe video.

Trajnimin fillestar e kanë ndjekur (37) gjyqtarë të sapoemëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.





Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)  
<https://ad.rks-gov.net>